



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2020:066853  
Datë: 10.10.2024  
Numri i dokumentit: 06277376

Pml.nr.443/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Mejreme Memaj, kryetare kolegjii, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë të kolegjii, me bashkëpunëtorin profesional Bujar Balaj, si procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit A. B., nga fshati ..., komuna e K., për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge” nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9. e lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), si dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 374, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas kërkesës për mbrojtje të ligjshmërisë të mbrojtësit të të dënuarit, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.24/2022, të datës 13.12.2023 dhe aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.103/2024, të datës 11.03.2024, në seancën e kolegjii të mbajtur më datën 28.08.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me aprovimin e kërkesës së mbrojtësit të të dënuarit A. B. për mbrojtje të ligjshmërisë, anulohet aktgjykimi i Gjykatës së Apelit të Kosovës - Departamenti për Krime të Rënda, PAKR.nr.103/2024, i datës 11.03.2024 dhe çështja i kthehet të njejtës gjykatë në rigjykim.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Rënda, PKR.nr.24/2022, të datës 13.12.2023, i dënuari A. B., është shpallur fajtor për shkak të veprës penale të kryer në bashkëkryerje “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e

paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge”, nga neni 273, paragrafi 2, lidhur me nenin 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, e ka gjykuar: për veprën penale nga dispozitivi I. i aktgjykimit, i ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 2,500 (dymijepesëqind) euro, të cilën gjobë është obliguar që ta paguaj në afat 30 (tridhjetë) ditësh, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, e të cilin dënim do mbajë pasi që ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Për veprën penale nga dispozitivi II. i aktgjykimit, gjykata ndaj të dënuarit ka shqiptuar dënim me gjobë në shumën prej 500 (pesëqind) euro, të cilin dënim i dënuari është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Gjykata konform dispozitive të nenit 80 të KPRK-së, të dënuarit i ka shqiptuar dënim unik dhe atë: dënim unik me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro, të cilin dënim i dënuari është obliguar që ta paguaj në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, si dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak, të cilin dënim do të mbajë, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari, dënimin me gjobë nuk e paguan në afat të caktuar, atëherë dënimin me gjobë, gjykata do t’ia zëvendësoi me dënim me burgim, duke ia llogaritur 1 (një) ditë burgim për çdo 20 (njëzetë) euro të gjobës.

I dënuari është obliguar që të paguaj shpenzimet e procedurës penale në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, si dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, të gjitha këto në afat prej 30 (tridhjetë) ditësh, pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Gjykata, konform nenit 273, paragrafi 5 të KPP-së ka konfiskuar narkotikun e llojit “Marihuanë” me peshë prej 52 (pesëdhjetë) kilogram e 900 (nëntëqind) gram, 1 (një) peshore digjitale e llojit “Grundig” dhe 1 (një) kompresor “Nuair”.

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.103/2024, e datës 11.03.2024, në pikën I. ka aprovuar ankesën e Prokurorisë Themelore në Pejë, ndërsa e ka ndryshuar aktgjykimin e lartcekur, vetëm sa i përket vendimit mbi dënimin e shqiptuar, ashtu që ndaj të dënuarit A. B., për veprat penale për të cilat është shpallur fajtor e ka gjykuar:

- për veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve” nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetëve, të cilin dënim do ta mbajë pasi ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë, si dhe dënim me gjobë në shumën prej 7000 (shtatë mijë) euro, ndërsa dënimin për veprën penale në bashkëkryerje “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga

neni 374, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, gjobë në shumë prej 500 (pesëqind) euro, ia merr të vërtetuar, ashtu që në kuptim të nenit 80 të KPRK-së, të dënuarit i shqipton dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vjetëve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim prej datës 22.05.2020 e deri më datë 16.10.2020, si dhe në masën e arrestit shtëpiak nga data 16.10.2020 e deri më datë 16.02.2021, dhe gjithashtu edhe dënim me gjobë në shumën prej 7500 (shtatë mijë pesëqind) euro. Dënimin me gjobë i dënuari obligohet ta paguaj në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë. Nëse i dënuari nuk e paguan dënimin me gjobë, atëherë dënimi me gjobë do të zëvendësohet në dënim me burgim, ku një (1) ditë burgim, do të barazohet me njëzet (20) euro të dënimit me gjobë. II. Ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit A. B., avokatit Haxhi Millaku. III. Në pjesët tjera aktgjykimi i ankimuar ka mbet i pandryshuar.

Kundër këtyre aktgjykimeve, kërkesë për mbrojtjen e ligjshmërisë ka paraqitur:

- mbrojtësi i të dënuarit A. B., avokati Haxhi Millaku nga P., për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 të Kodit të Procedurës Penale (KPP) dhe shkeljes së ligjit penal nga neni 385 të KPP-së, me propozimin që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar, të ndryshojë aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë, ashtu që aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë ta vërtetoi për shkak të veprës penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge”, nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ose ta anulojë aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës dhe lëndën ta kthejë në rigjykim.

Kryeprokurori i Shtetit, me shkresën KMLP.II.nr.253/2024, e datës 24.07.2024, ka propozuar që kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e mbrojtësit të të dënuarit Adem Berisha, të refuzohet si e pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, në seancën e kolegjit pasi i shqyrtoi shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 435, paragrafi 1 lidhur me nenin 436, paragrafi 1 të KPP-së dhe pasi i vlerësoi pretendimet nga kërkesa për mbrojtje të ligjshmërisë, konstatoi se:

- kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë është e bazuar.

Mbrojtësi i të dënuarit, në kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë pretendon se aktgjykimin i kundërshtuar është marrë me shkelje nga neni 384 të KPP-së, ngase dispozitivi i aktgjykimit të kundërshtuar është i pakuptueshëm kundërthënës me brendinë dhe arsyetimin e tij, i pabazuar në prova, sepse i pandehuri ka bërë pranimin e fajësisë dhe atë gjatë fazës së hetimeve, mbi bazën e aktvendimit për fillimin e hetimeve të paraqitur nga prokuroria Themelore në Prishtinë me përshkrim faktik dhe emërtim ligjor – cilësim juridik të veprës penale blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve nga neni 273, paragrafi 1 të KPRK-së, e jo si në aktakuzë dhe në aktgjykim ku është përfshirë paragrafi 2 i nenit 273 i KPRK-së. Njëherit, mbrojtësi pretendon se ka shkelje të natyrës esenciale të

procedurës penale e të cilat shkelje kanë rezultuar me shkelje të dispozitave të nenit 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9. të KPRK-së, dhe në kundërshtim me nenin 5 e 3 të KPRK-së, janë vlerësuar në mënyrë të kundërligjshme dhe në dëm të dënuarit kur Gjykata e Apelit e Kosovës ia rrit dënimin nga dënimi prej dy vjetëve në pesë vjet, në kundërshtim me nenet 38, 67, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së. Gjithashtu, thekson se është shkelur ligji penal si rezultat i shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, ku në rastin konkret konsideron se shkeljet janë në cilësimin juridik të akuzës në dispozitivin e saj për të cilin i dënuari është shpallur fajtor dhe është dënuar në dyfishin e minimumit ligjor. Andaj, thekson se në praktiken juridike nuk ka ndonjë rast që dikush të shpallet fajtor për këtë veprë penale mbi bazën e pranimit të fajësisë dhe të dënohet mbi dyfishin e dënimit ligjor të paraparë.

Gjykata Supreme e Kosovës pas vlerësimit të pretendimeve ankimore të ngritura në kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë ka gjetur se aktgjykimi i shkallës së dytë përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nga neni 384 par.2, nënpar.2.7 lidhur me nenin 394 të KPP-së, ngase aktgjykimi i shkallës së dytë nuk është përpiluar konform dispozitave ligjore.

Siç del nga shkresat e lëndës me aktgjykimin e shkallës së parë i dënuari është shpall fajtor për veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge”, nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 281, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjykata konform dispozitave të nenit 80 të KPRK-së, të dënuarit i ka shqiptuar dënim unik dhe atë: dënim unik me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 2 (dy) vjetëve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak.

Sipas dispozitës së nenit 369, paragrafi 8 të KPP-së, kur i akuzuari dënohet me burgim, arsyetimi përfshin rrethanat të cilat gjykata i ka marrë parasysh me rastin e caktimit të dënimit. Gjykata veçanërisht arsyeton se në cilat shkaqe është bazuar kur ka konstatuar se ka të bëjë me veçanërisht me rast të rëndë dhe se duhet shqiptuar dënim me të rëndë nga ai i paraparë, ose ka konstatuar se është e nevojshme të ulë apo heqë dënimin, të shqiptoj dënim alternativ apo ndonjë masë ose të konfiskohet dobia pasurore e fituar me veprë penale (dispozitë kjo që aplikohet në mënyrë analoge edhe nga gjykata e shkallës së dytë). Siç del nga shkresat e lëndës me aktgjykimin e shkallës së parë i dënuari është shpall fajtor për veprën penale “Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve dhe substancave psikotrope apo analoge”, nga neni 273, paragrafi 2 lidhur me nenin 281 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.9 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së, si dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 374, paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së. Gjykata konform dispozitave të nenit 80 të KPRK-së, të dënuarit i ka shqiptuar dënim unik dhe atë: dënim unik me gjobë në shumën prej 3000 (tremijë) euro, si dhe dënim me burg në kohëzgjatje

prej 2 (dy) vjetëve, në të cilin dënim i është llogaritur edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak. Ndaj aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë me të cilin i dënuari është dënuar me burgim, ka ushtruar ankesë prokurori i shtetit sa i përket vendimit për dënimin dhe konfiskim, të cilën ankesë e ka aprovuar gjykata e shkallës së dytë duke e rritur dënimin me burgim, mirëpo, nuk e ka arsyetuar faktin se pse ankesa e prokurorit është e bazuar dhe të dënuarit i është ashpërsuar dënimi. Në arsyetim të aktgjykimit të shkallës së dytë ndër të tjera theksohet se “kolegji duke i rivlerësuar të gjitha rrethanat e konstatuara nga gjykata e shkallës së parë, e duke marrë për bazë pranimin e fajësisë, sjelljet e mëparshme konform nenit 69, paragrafi 3, nën-paragrafi 3.5 të KPRK-së, se i dënuari edhe më parë ka kryer vepër tjetër penale, si dh faktin e sasisë së narkotikut, e duke pasur parasysh mënyrën e kryerjes së secilës vepër penale, si dhe shkallën e intensitetit të kryerjes së të njëjtave, të dënuarit i ka shqiptuar dënim me burgim sikurse në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se me të njëjtin do të arrihet qëllimi i dënimit”. Mirëpo, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk është e mjaftueshme vetëm të theksohet se ankesa është e bazuar dhe të citohen rrethanat, por duhet të jepen sqarime konkrete përkitazi me rrethanat dhe pse këto rrethana (të cilat duhet të mos jenë elemente të veprës penale) të cilat i ka theksuar prokurori në ankesë në raport me rrethanat lehtësuese të cilat i ka vlerësuar gjykata e shkallës së parë e arsyetojnë rritjen e dënimit. Andaj, me këto rrethana të konstatuara, gjykata e shkallës së dytë ka dyfishuar rrethanat rënduese në dëm të të dënuarit, pasi që si rrethana rënduese ka çmuar rrethana të pa vërtetuara, përkundër faktit se gjykata e shkallës së dytë ka mundësinë e ashpërsimit të dënimit, mirëpo me këtë rast duhet që të arsyetoj në mënyrë të posaçme rrethanat që kanë ndikuar në shqiptimin e dënimit më të ashpër në raport me gjykatën e shkallës së parë.

Duke pasur parasysh se gjykata e shkallës së dytë nuk ka vepruar konform dispozitës së lartcekur, pra, nuk i ka shqyrtuar pretendimet në pjesën për të cilën është ushtruar ankesë, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykim i shkallës së dytë është i përfshirë me shkeljet e lartcekura, ngase juridikisht është i paqëndrueshëm, për çka u deshtë të anulohet e të cilat shkelje, gjykata e shkallës së dytë duhet t'i vlerësojë dhe evitojë me rastin e rigjykimit dhe pastaj të marrë një vendim të drejtë në këtë çështje juridiko-penale.

Nga arsyet e lartcekura kjo gjykatë konform dispozitës së nenit 438, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pml.nr.443/2024, më datë 28.08.2024

Bashkëpunëtori profesional,  
Bujar Balaj

Kryetarja e kolegjit,  
Mejreme Memaj